

MUAJI I KUJTESËS

Muzeu Kombëtar hap ekspozitën me sende të të dënuarve politike

Në kuadër të "Muajit të Kujtesës", të iniciuar nga Ministria e Kulturës, Muzeu Historik Kombëtar organizoi një ekspozitë me objekte personale të personave që kanë vuajtur nga regjimi komunist si edhe me piktura të Lekë Tasisit. Piktori foli rreth librit të tij "Grabjani rrëzë kodrave", ku rrëfeu ngjarje, që ka përjetuar gjatë viteve të internimit. Ai tha se libri pasqyron një realitet të zi e të hidhur, që shumë shqiptarë vetëm kanë dëgjuar. Libri është një pasqyrë e gjallë, me të vërteta tronditëse, që asnjëherë ata që i kanë provuar s'kanë për t'i harruar, çka të mban të mbërthyer e gjithë ankth, për episodet nga jeta reale, të paraqitura rrjedhshëm, thjesht e me një të vërtetë absolute, në atë realitet aq të dhimbshëm e të tmerrshëm. Muaji shkurt është caktuar si "Muaji i Kujtesës", për shkak të atyre ngjarjeve, që do të ndryshonin rrjedhën e historisë shqiptare, prandaj këto aktivitete janë jo vetëm për të kujtuar, por edhe për t'u solidarizuar, ndaj ngjarjeve që na kanë prekur të gjithëve.

DOKUMENTET

Biblioteka Kombëtare hap ekspozitën me libra të ndaluar në komunizëm

Për herë të parë Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë, në kuadër të "Muajit të Kujtesës", çeli të enjten një ekspozitë kushtuar temës së librave të ndaluar për publikun gjatë komunizmit. Krahas librave të ndaluar, në ekspozitën "Libra të ndaluar në komunizëm" u publikuan dhe një sërë dokumentesh arkivorë, lidhur me politikën, udhëzimet, urdhrat lidhur me ndalimin e librave, botimit të autorëve të shpallur si armiq të dënuar nga regjimi i kohës, pastrim të botimeve të elementëve armiq, autorë shqiptarë dhe të huaj, botime brenda Republikës së Shqipërisë por edhe jashtë saj. Publikimi i dokumenteve u bë e mundur në sajë të bashkëpunimit me Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivit Shtetëror. Ekspozita hapet me vendimin e Gjykatës Popullore të Tiranës, publikuar në gazetën "Bashkimi" më datë 27 mars të vitit 1948, përmes së cilës vendosej heqja nga qarkullimi i librave dhe të përkohshmeve "të dëmshme për shoqërinë", për të vijuar me urdhëresat të ndryshme të Ministrisë së Arsimit dhe Kulturës, duke hequr nga qarkullimi veprat të autorëve, redaktorëve ose përkthyesve dhe duke vulosur me gërmën "R" (Rezervat).

FESTIVALI

Ministria e Kulturës cakton shtatorin si muajin e Festivalit Folklorik të Gjirokastrës

Ministria e Kulturës përcakton muajin kur do të zhvillohet Festivali Folklorik Kombëtar i Gjirokastrës. Lajmi bëhet i ditur nga Ministria e Kulturës, Elva Margariti, e cila njofton se Festivali Folklorik Kombëtar i Gjirokastrës, manifestimi më i rëndësishëm i trashëgimisë sonë shpirtërore, do të zhvillohet në muajin shtator 2020, në Kalanë e Gjirokastrës. "Pas tërmetit të 26 Nëntorit 2019 vendi u përball me një situatë të jashtëzakonshme, ku primare ishte akomodimi i menjëhershëm 17 mijë banorëve dhe hartimi i projekteve të rindërtimit. Në këtë situatë u vendos që festivali të organizohet në muajin shtator. Ky festival është shembull i shpirtit krijues të shqiptarëve dhe vitalitetit, i aftë për t'u ringritur pas çdo vështirësie", shprehet ministria Margariti, duke siguruar se Ministria e Kulturës ka siguruar financat e duhura për organizimin e këtij aktiviteti.

TËRMETI

Rindërtimi, Ministria Margariti prezanton modelet e banesave të reja

Kryeministri Edi Rama, Ministri i Shtetit për Rindërtimin, Arben Ahmetaj dhe Ministria e Kulturës, Elva Margariti prezantuan modelet e shtëpive për të pastrehët e tërmetit të 26 nëntorit 2019. Gjatë prezantimit, Ministria Margariti u shpreh se në gjithë vendin do të ndërtohen nga e para 7 981 banesa kolektive dhe 806 banesa individuale dhe objekte shëndetësore, arsimore e kulturore, në 400 ha. Për sa i takon banesave individuale, projekti parashikon 3 modele banesash 1-katëshe me teknologji modulare, kopsht bujqësor, oborr dhe verandë. Organizimi i shtëpisë në formë modulare bën që godina të shumëfishohet apo zgjerohet me dhoma apo hapësira shtesë sipas nevojës dhe ofron komoditet optimal jetese duke siguruar jetëgjatësi të ndërtesës. Sipas Ministres Margariti, banesat sigurojnë kursim të energjisë 20-30 %, janë me materiale të riciklueshme 90% dhe me standarde maksimale ndërtimi EUROCODE 8, rezistente ndaj tërmeteve deri në 9 ballë. Përparësitë e teknologjisë janë montimi i shpejtë bashkë me infrastrukturën lidhëse, brenda 30 ditëve, si dhe kursim energjie deri në 15 mijë lekë në vit dhe jetëgjatësi e lartë me garanci deri në 70 vite.

PROJEKTI

Qeveria miraton mbështetjen për ndërtimin e Korpusit të Universitetit të Arteve

Pas restaurimit të godinës historike të Universitetit të Arteve dhe punës për rikonstruksionin e Sallës së Koncerteve, së shpejti do të nisë puna për ndërtimin e Kampusit të ri Universitar të Arteve. Ministria e Kulturës, Elva Margariti, në Kongresin e Partisë Socialiste prezantoi ndryshimin rrënjësor që do të pësojnë hapësirat e UA. "Tashmë Qeveria ka miratuar skemën mbështetëse buxhetore për t'i dhënë jetë këtij kampusi, ku gjurmës historike i shtohen jo vetëm ambientet e reja të 4 fakulteteve, laboratorët, biblioteka vitale, por edhe 2 salla të reja multifunksionale. Një sipërfaqe prej 28 000 m², nga do të përfitojnë jo vetëm 1300 studentë e pedagogë, por edhe qindra artistë e qytetarë, sot lexohen thjesht numra, që nuk arrijnë të shprehin emocionalisht, se si ky pol i ri kulturor do të pulsojë fuqishëm. Ky projekt lindi prej dialogut dhe ndaj meriton të kthehet në një hapësirë të përbashkët dialogu, pa mure mes Akademikes dhe Publikes", tha ministria Margariti.